

PARTIA ALEANCA DEMOKRISTIANE (PDK)

HISTORIKU

Partia Demokristiane (PDK) u krijua në Tiranë në dhjetor të vitit 1991. Gjatë kësaj kohe Delegacioni i Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës bëri vizitën e parë zyrtare në Shqipëri. Kryesuesi i këtij delegacioni ishte Besnik Bardhi, në ambientet e Hotel Arbëria në Tiranë, ai i dorëzoi programin dhe statutin e kësaj partie personit të autorizuar Ndrekë Luca, në prani të Agim Gjakova dhe Esat Myftari. Kjo sepse zanafilla e rrënjëve demokristiane në Shqipëri dhe në Kosovë ishte e përbashkët dhe daton me organizimin politik të drejtuar nga Luigj Gurakuqi 'Ora e Maleve'. Më 17 shkurt 1945 u krijua organizata "Bashkimi Shqiptar", në krye të së cilës u zgjodh Patër Gjon Shllaku. Partia Demokristiane, me këtë emërtim, u krijua për herë të parë me 27 prill 1945, nën drejtimin e Arqipeshkvit metropolitan monsinjor Gaspër Thaçit. Në këtë mbledhje, u zgjodhën dhe drejtuesit e Demokristianes: kryetar u zgjodh Monsinjor Gaspër Thaçi, nënkryetar patër Anton Arapi dhe monsinjor Vincens Prenushi. Partia Demokristiane në këtë kohë ishte e vetmja parti politike që ndante të njejtin program dhe vizion politik me familjen e madhe kristiandemokrate dhe demokristiane europiane. Për shkak të këtij misioni politik të Partisë Demokristiane regjimi komunist ndoqi, arrestoi, persekutoi dhe dënoi me ashpërsi të gjithë themeluesit, drejtuesit dhe mbështetësit e lëvizjes demokristiane. Me rënien e sistemit komunist, u mundësua dhe vizita e PSHDK dhe themelimi i PDK në Shqipëri më 11 dhjetor 1991 nga një grup intelektualësh shqiptarë. Më 25 dhjetor 1993 doli dhe numri i parë i gazetës "Ora e Shqipërisë", organ i Partisë Demokristiane. Më 27 shkurt 1994 zhvillon punimet në Tiranë Kongresi i Parë i PDK-së, i cili zgjodhi kryetar Zef Bushatin. Në zgjedhjet e 26 majit 1996 PDK është në koalicion me PD-në dhe megjithëse nuk fiton ndonjë mandat deputeti për në parlament, ajo është pjesë e qeverisjes së PD-së, ku Zef Bushati është në postin e këshilltarit të Kryeministrit ndërsa Nikolin Kurti është në postin e zëvendëministrit të Transporteve. Në zgjedhjet lokale të tetorit të të njëjtit vit, PDK fiton Kryetarin e Komunes së Shengjinit, në rrethin e Lezhës dhe Kryetarin e Komunes në Velipojë dhe mjaft anetarë në Këshillat e Bashkive, Rretheve dhe Komunave. Më 9 mars 1997 PDK është një nga dhjetë partitë kryesore që nënshkruan deklaratën për të kapërcyer gjendjen e jashtëzakonshme të krijuar në Shqipëri. Më 12 mars 1997 formohet qeveria e Pajtimit Kombëtar dhe Partia Demokristiane përfaqësohet në Kabinetin Qeveritar me Ministrinë e Kulturës Engjëll Ndocaj. Në qershor 1997 Partia Demokristiane merr pjesë në formacionin politik "Bashkimi për Demokraci" dhe nënshkruan marrëveshjen paraelektorale me Partinë Demokratike, Partinë Lëvizja e Legalitetit, Partinë Bashkimi Socialdemokrat dhe Partinë Bashkimi Demokrat. Në zgjedhjet e 28 qershorit 1997, PDK fiton dy deputetë. Në zgjedhjet e 24 qershorit 2001 PDK nuk arrin që të përfaqësohet në parlament. Në zgjedhjet e 3 korrikut 2005, PDK në koalicion me PD-në arrin që të përfaqësohet sërish nga dy deputetë në parlamentin e Shqipërisë. Nga viti 2002 deri në vitin 2006, PDK u

drejtua nga Nikollë Lesi, ndërkohë që nga viti 2006 kryetar i PDK është Nard Ndoka. Gjatë viteve 2007 – 2008 ai shërbeu dhe si Ministër i Shëndetësisë. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2009, 2013 dhe 2017, elektorati i PDK edhe si pasojë e sistemit të ri zgjedhor ra, sidoqoftë, në zgjedhjet e vitit 2017, kryetari i saj Nard Ndoka mundi që të ishte sërish deputet nga listat e Partisë Demokratike.

KRYETARI - NARD NDOKA

BIOGRAFIA

Nard Ndoka e nisi karrierën e tij në politikë si anëtar i Partisë Demokratike në fillim të viteve 1990-të. Më vonë ai do të ishte kryetar i Bashkisë Vau i Dejës, e cila ishte dhe vendlindja e tij dhe ku ai kishte punuar dhe në pozicionin e sekretarit të Bashkisë. Nard Ndoka arriti që të zgjidhej deputet në zgjedhjet elektorale të vitit 2005 dhe një vit më pas të bëhej kryetar i Partisë Demokristiane, duke pasuar në këtë pozicion Nikollë Lesin. Gjatë viteve 2007 – 2008 ai do të ishte Ministër i Shëndetësisë në qeverinë Berisha I. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2017 Nard Ndoka do të zgjidhej deputet nga listat e Partisë Demokratike, sidoqoftë Partia Demokristiane do të ishte në koalicion me PD-në, dhe ai do ta digjte mandatin e tij të deputetit në shkurt të vitit 2019.